



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN**  
**Fakulteti Ekonomik – Economics Faculty**

Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës

[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net), tel. +383 (0) 28039011

UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" Public University		
Prof. Ar Agaj Data:	05.09.2022	
Nësa Organizatave:	Numer:	05/1527

Duke u bazuar në Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar, në Universitetin Publik "Kadri Zeqa" Gjilan, nr.ref.01/1473, dt.09.07.2021 dhe kriteret e paraqitura në Konkursin me nr. ref. 01/1905, dt.13.09.2021; për angazhim në Fakultetin Ekonomik, viti akademik 2021/22, Komisioni në përbërje: Prof.Asoc.Dr. Shefket Jakupi, Prof.Ass.Dr. Nexhat Shkodra dhe Prof.Ass.Dr. Teuta Agaj, pasi ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet dhe pasi, më datë 02.09.2022, ka realizuar intervistimin e të gjithë kandidatëve që kanë plotësuar kushtet formalo-juridike, ka përgatitur raportin me rezultatet sipas pozitave të konkursit me arsyetimet përkatëse.

**RAPORT I KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK PËR ANGAZHIM NË SEMESTRIN DIMËROR DHE VEROR - VITI AKADEMIK 2022/23 NË FAKULTETIN EKONOMIK**

Pozita	Kandidati	Propozimi
1. Një mësimdhënës - për mbajtjen e ligjëratave në semestrin veror për lëndët:  <i>Ekonomiksi i sektorit publik dhe Etika ne biznes</i>	Refik Kryeziu	Komisioni <b>propozon</b> që Prof.Ass.Dr. Refik Kryeziu të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati ka qenë profesor i rregullt i Fakultetit Ekonomik deri në vitin akademik që lamë pas, me thirrjen Profesor Asistent. Me një përvojë në mësimdhënien universitare afër 20 vjeçare, ku përfshihen edhe lëndët të shpallura në konkurs, ai i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë.
	Herolinda Murati Leka	Kandidatja, Dr.sc.Herolinda Murati Leka, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike, por kandidati i propozuar është dukshëm në përparësi në raport me te. Për dallim nga kandidati i propozuar, kandidatja nuk ka thirrje akademike Prof.Ass dhe nuk e ka përvojën e tij, si bartës i lëndëve - profesor.
	Gëzim Jusufi	Është propozuar në pozitë tjetër.
2. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:  <i>Bazat e kontabilitetit financiar dhe Parimet e kontabilitetit</i>	Artan Hajdini	Komisioni <b>propozon</b> që kandidati PhD.Cand. Artan Hajdini të zgjidhet për këtë pozitë Kandidati i plotëson të gjitha kushtet formalo juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Gjithashtu në të njëjtën fushë të studimit është duke ndjekur studimet e doktoratës si dhe ka të kryera edhe kurse profesionale në fushën e kontabilitetit (SCAK) si dhe ka përvojë në mësimdhënie

dhe semestrin veror: <i>Bazat e kontabilitetit</i>		universitare. Komisioni, pasi bëri edhe intervistimin e kandidatit, erdhi në përfundimin që të njëjtin ta propozoj për këtë pozitë.
	Arben Nimanaj	Është propozuar në pozitë tjetër.
3. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:  <i>Matematike per ekonomiste</i>  dhe semestrin veror:  <i>Bazat e statistikes dhe Matematikë financiare</i>	Shkurte Morina	Komisioni <b>propozon</b> që kandidatja MSc. Shkurte Morina të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatja i plotëson të gjitha kushtet formalo juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo ka qenë edhe vitin e kaluar e angazhuar në UKZ ku ka treguar sukses në mësimdhënie që është dëshmuar edhe nga vlerësimi i studentëve. Komisioni, pasi bëri edhe intervistimin e kandidatit, erdhi në përfundimin që të njëjtin ta propozoj për këtë pozitë.
	Agon Mahmuti	Kandidati, PhD.Can. Agon Mahmuti, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Kandidati ka pasur angazhime në të kaluarën për këto lëndë dhe ka treguar performancë shumë të mirë. Por, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni në mesin e dy kandidatëve i dha përparësi kandidates duke marrë parasysh edhe barazinë gjinore.
	Rrezehana Hasani Abazi	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Matematikës.
	Erjona Huruglica	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Matematikës.
4. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:  <i>Vendosja ne biznes, Menaxhimi i projekteve, Menaxhim i BMV</i>  dhe semestrin veror:  <i>Menaxhmenti strategjik dhe Bazat e menaxhmentit</i>	Fatlind Morina	Komisioni <b>propozon</b> që PhD.Cand. Fatlind Morina, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatit i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ai gjithashtu është duke vazhduar studimet e doktoratës në të njëjtën fushë, ndërsa ka pasur angazhime në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së edhe në të kaluarën për disa nga këto lëndë dhe ka treguar performancë të shkëlqyeshme, të vlerësuar nga studentët. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për këtë pozitë dhe ka përparësi në raport me kundër kandidatët.
	Mentor Rashiti	Kandidati, PhD.Cand. Mentor Rashiti, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe

		<p>notës mesatare. Ai nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe ka diferencë të theksuar në notë mesatare në krahasim me kandidatin e propozuar.</p> <p>Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
	Erjona Huruglica	<p>Kandidatja, MSc.Erjona Huruglica, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar.</p> <p>Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
<p>5. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Hulumtimi ne biznes, Metodat e hulumtimit ne biznes, menaxhimi i operacioneve</i></p> <p>dhe semestrin veror:</p> <p><i>Sjellje organizative, Etika ne biznes, Menaxhimi i riskut dhe sigurimet</i></p>	<b>Edona Haxhiu</b>	<p>Komisioni <b>propozon</b> që kandidatja, PhD.Cand. Edona Haxhiu, të zgjidhet për këtë pozitë.</p> <p>Kandidatja është njëra ndër kandidatët që i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike, për sa i takon fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo ka kryer studimet bachelor në Institutin joprofitabil American University of Kosova (AUK) me drejtim primar në fushën e menaxhmentit, ndërsa studimet master i ka kryer në Universitetin e Lubjanës në fushën e Ndërmarrësisë. Në të njëjtin universitet, ka vazhduar edhe studimet e doktoratës ku fushë të studimit ka ndërmarrësinë dhe menaxhimin e riskut, që është më e përshtatshme se kandidatët tjerë për lëndët ku do të mbajë ushtrimet.</p> <p>Pos kësaj, Komisioni ka marrë për bazë edhe performancën e kandidatës nga angazhimet e viteve të kaluara, e cila ka marrë vlerësim të shkëlqyeshëm nga studentët. Prandaj Komisioni konsideron se kjo kandidate duhet të vazhdojë edhe këtë vit të mbajë ushtrimet në këto lëndë.</p>
	Abetare Prebreza	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Erjona Huruglica	<p>Kandidatja, MSc.Erjona Huruglica, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie në</p>

		arsimin e lartë si dhe nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Erleta Halimi	Kandidatja, MSc.Erleta Halimi, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket notës mesatare dhe pjesërisht fushës së studimit pasi ka bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Fatlind Morina	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Gëzim Jusufi	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Mentor Rashiti	Kandidati, PhD.Cand. Mentor Rashiti, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ai nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe ka diferencë në notë mesatare në krahasim me kandidatin e propozuar. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Rrezehana Hasani Abazi	Është propozuar në tjetër pozitë.
6. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:  <i>Analize mikroekonomike e tregut, Menaxhimi inovacionit dhe dijes, Analize e investimeve</i>  dhe semestrin veror:	<b>Abetare Prebreza</b>	Komisioni <b>propozon</b> që PhD.Cand. Abetare Prebreza, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatja i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo gjithashtu është duke vazhduar studimet e doktoratës në të njëjtën fushë dhe ka një dosje të pasur sa i përket kërkimit shkencor nga këto fusha me mbi 4 punime në revista ndërkombëtare, punime në revista vendore dhe 5 pjesëmarrje në konferenca vendore e ndërkombëtare si dhe bashkë-autore në disa projekte shkencore. Ajo ka pasur angazhime në UKZ-së edhe në të kaluarën.

<p><i>Menaxhim i investimeve, Menaxhimi i resurseve humane, Integritet ekonomike ne BE-së</i></p>		Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për këtë pozitë dhe ka përparësi në raport me kundër kandidatët.
	Erjona Huruglica	Kandidatja, MSc.Erjona Huruglica, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Fatind Morina	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Gëzim Jusufi	Është propozuar në tjetër pozitë.
	Mentor Rashiti	Kandidati, PhD.Cand. Mentor Rashiti, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ai nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe ka diferencë të theksuar për sa i përket punës kërkimore shkencore në krahasim me kandidatin e propozuar. Kandidati ka njoftuar se ka një punim në proces botimi. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Rrezehana Hasani Abazi	Është propozuar në tjetër pozitë.
<p>7. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Mikroekonomi I, Makroekonomi II</i></p> <p>dhe semestrin veror:</p> <p><i>Ekonomiksi i sektorit publik, Ekonomia e KS dhe mjedisi ne biznes,</i></p>	Gëzim Jusufi	<p>Komisioni <b>propozon</b> që kandidati, Dr.sc. Gëzim Jusufi, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike, për sa i përket fushës së studimit, notës mesatare por edhe përvojës në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor. Kandidati ka të kryer studimet e doktoratës në fushën e Ekonomiksit si dhe ka një përvojë të gjatë edhe në mësimdhënie në nivelin universitar në UKZ si dhe ka një dosje të pasur në aspektin e kërkimit shkencor.</p> <p>Prandaj Komisioni konsideron se ky kandidat është</p>

<p><i>Ekonomia e KS dhe zhvillimi, Makroekonomi I</i></p>		dukshëm në përparësi në raport me të tjerët dhe duhet të vazhdojë edhe këtë vit të mbajë ushtrimet në këto lëndë.
	Erjona Huruglica	Nuk propozohet për këtë pozitë pasi nuk është nga fusha e Ekonomiksit.
<p>8. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Qeverisja korporative, Menaxhimi dhe E-qeverisja</i></p> <p>dhe semestrin veror:</p> <p><i>Planifikimi dhe implementimi i E-qeverisjes, Menaxhimi publik dhe administrimi</i></p>	Rrezehana Hasani Abazi	Komisioni <b>propozon</b> që PhD.Cand. Rrezehana Hasani Abazi, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidatja i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo gjithashtu është duke vazhduar studimet e doktoratës në fushën e menaxhmentit dhe informatikës, ndërsa ka pasur angazhime në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së edhe në të kaluarën dhe ka treguar performancë të shkëlqyeshme të vlerësuar nga studentët. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për këtë pozitë dhe ka përparësi në raport me kundërkandidatët.
	Artan Hajdini	Është propozuar në tjetër pozitë
	Erjona Huruglica	Kandidatja, MSc.Erjona Huruglica, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar, sidomos në këtë rast kur bëhet fjalë për lëndë në nivelin MSc. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.
	Gëzim Jusufi	Është propozuar në tjetër pozitë
<p>9. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Tregjet dhe institucionet financiare, Financat, Financa nderkombetare, Sistemi tatimor</i></p> <p>dhe semestrin veror:</p>	Arben Nimanaj	Komisioni <b>propozon</b> që kandidati, PhD.Cand.Arben Nimanaj, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati është njëri ndër kandidatët që i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike si dhe duke u mbështetur në performancën e treguar gjatë angazhimit të tij në tri vitet e kaluara akademike. Kandidati ka marrë vlerësim të shkëlqyeshëm nga studentët si dhe profesorët me të cilët ka punuar. Ai ka të përfunduar studimet bachelor dhe master në fushën e Banka, Financa dhe Kontabilitetit si dhe vazhdon studimet e doktoratës në të njëjtën fushë në Universitetin e Prishtinës. Prandaj Komisioni

<p><i>Financat e korporatave, Financa nderkombetare, Tregjet dhe institucionet financiare, Makroekonomi I, Ekonomiksi monetar</i></p>		<p>konsideron se ky kandidat duhet të vazhdojë edhe këtë vit të mbajë ushtrimet në këto lëndë.</p>
	<p>Artan Hajdini Erleta Halimi</p>	<p>Është propozuar në tjetër pozitë Kandidatja, MSc.Erleta Halimi, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket notës mesatare dhe fushës së studimit. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
<p>10. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Marketingu, Kerkimet e marketingut, Menaxhimi i brendit dhe komunikimi, Marketingu nderkombetar</i></p> <p>dhe semestrin veror:</p> <p><i>Strategjite e marketingut, Menaxhimi i shitjeve, B2B Marketingu</i></p>	<p>Asdren Toska</p>	<p>Komisioni propozon që PhD.Cand. Asdren Toska, të zgjidhet për këtë pozitë. Kandidati i plotëson më së miri kushtet për tu zgjedhur për këtë pozitë nga kandidatët e tjerë. Ai përpos që i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare, është duke vazhduar studimet e doktoratës në të njëjtën fushë dhe ka një dosje të pasur sa i përket kërkimit shkencor nga këto fusha. Veç tjerash ka të publikuara dy punime shkencore si autor i parë në revista prestigjioze të botuesit Emerald Publishing indeksuara në Web of Science dhe Scopus me faktor impakti mbi 4.. Po ashtu ka pjesëmarrje me punime në konferenca shkencore. Ai ka pasur angazhime në Fakultetin Ekonomik në UKZ-së edhe në të kaluarën për disa nga këto lëndë, ku ka marrë vlerësime të shkëlqyeshme nga studentët. Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më i përshtatshëm për këtë pozitë dhe ka përparësi në raport me kundërkandidatët.</p>
	<p>Arboneta Lecaj</p>	<p>Nuk ka marrë pjesë në intervistë.</p>
	<p>Gëzim Jusufi</p>	<p>Është propozuar në tjetër pozitë.</p>
	<p>Shaqir Durmishi</p>	<p>Kandidati, PhD.Cand. Shaqir Durmishi, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ai ka të regjistruara studimet e doktoratës ndërsa nuk ka ofruar dëshmi për punën kërkimore shkencore. Kandidati ka qenë i angazhuar për dy semestra në Fakultetin Ekonomik për mbajtjen e ushtrimeve dhe komisioni ka marrë parasysh edhe vlerësimet e studentëve për të bërë</p>

		<p>krahasimin me kandidatin e propozuar.</p> <p>Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati e propozuar është më i përshtatshëm për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
	Shqiprim Jashari	<p>Kandidati, PhD.Cand. Shqiprim Jashari, nuk propozohet për këtë pozitë. Ai i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare si dhe ka të regjistruara studimet e doktoratës. Kandidati nuk ka përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë si dhe ka diferencë të theksuar për sa i përket punës kërkimore shkencore në krahasim me kandidatin e propozuar.</p> <p>Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati e propozuar është më i përshtatshëm për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
	Valarta Qerimi	<p>Kandidatja, MSc.Valarta Qerimi, nuk propozohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës dhe nuk ka ofruar dëshmi për punë kërkimore për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar. Kandidatja ka qenë e angazhuar disa vite më herët si për mbajtjen e ushtrimeve në disa lëndë në Fakultetin Ekonomik.</p> <p>Prandaj, pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidati i propozuar është më e përshtatshëm për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
<p>11. Një asistent/e për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror:</p> <p><i>Gjuhë angleze II</i></p> <p>dhe semestrin veror:</p> <p><i>Gjuhë angleze I</i></p>	<p>Donjeta Latifaj</p>	<p>Komisioni propozon që kandidatja, Dr.sc. Donjetë Latifi, të zgjidhet për këtë pozitë.</p> <p>Kandidatja i plotëson më së miri kushtet për këtë pozitë, duke marrë për bazë kushtet formalo-juridike si dhe duke u mbështetur në performancën e treguar gjatë angazhimit të saj në vitet e kaluara akademike. Kandidatja ka marrë vlerësim të shkëlqyeshëm nga studentët. Ajo ka të përfunduar studimet bachelor në Universitetin e Prishtinës për Gjuhë angleze kurse studimet master dhe te doktoratës në të njëjtën fushë i ka mbaruar në Universitetin e Evropës Juglindore. Prandaj Komisioni konsideron se kjo kandidate duhet të vazhdojë edhe këtë vit të mbajë ushtrimet në këto lëndë.</p>
	Ardita Haziri	<p>Kandidatja, MSc.Ardita Haziri Aliu, nuk</p>



	Aliu	<p>proponohet për këtë pozitë. Ajo i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare. Ajo nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës për çka është në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar e cila është doktor shkence në këtë fushë.</p> <p>Prandaj, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe realizimit të intervistës, Komisioni konsideron se kandidatja e propozuar është më e përshtatshme për të vazhduar edhe këtë vit në angazhimin për këtë pozitë.</p>
--	------	--

### KANDIDATËT QË NUK I KANË PLOTËSUAR KUSHTET FORMALO-JURIDIKE

Nr.	Kandidati	Kushtet formalo-juridike që nuk i ka plotësuar
1	Fjolla Matoshi	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
2	Lejla Hoda Hasani	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
3	Saranda Abdyl-Aliu	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
4	Armend Limoni	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
5	Nesrin Jahja	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
6	Fatlume Xheladini	Certifikata e lëshuar nga Gjykata që nuk është nën hetime, nuk është origjinale apo e noterizuar.
7	Mihrije Maloku-Morina	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 1 dhe 2
8	Florim Selver-Hyseni	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
9	Edlira Latifaj-Rexhepaj	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
10	Vjollca Salihu	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 1 nën paragrafi 1 (doktorata nuk

		është në lëmi përkatëse)
11	Ermira Dermaku	Është studente aktive në Programin Menaxhement dhe Ndërmarrësi (BSc).
12	Kushtrim Vllasaj	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.
13	Arlinda Demiri-Latifaj	Nuk plotësohet kriterin sipas nenit 12 të Rregullores, përkatësisht paragrafi 2 nën paragrafi 2.

Gjilan, më: 05.09.2022

Anëtarët e Komisionit:

1. Prof.Asoc.Dr. Shefket Jakupi – kryetar

  
\_\_\_\_\_

2. Prof.Ass.Dr. Nexhat Shkodra – anëtar

  
\_\_\_\_\_

3. Prof.Ass.Dr. Teuta Agaj – anëtar

  
\_\_\_\_\_



UNIVER